Kronikë

Kurbin, kanosi me thikë disa qytetarë dhe dëmtoi një makinë, arrestohet 43-vjeçari, i dënuar më parë për vjedhje me armë (EMRI)

Policia e Kurbinit arrestoi një 43 vjeçar, pas raportimeve për kërcënime ndaj qytetarëve dhe dëmtim pronash. Gjatë operacionit "Rekordet," iu sekuestruan një thikë, municion luftarak dhe Cannabis. Materialet iu kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme, teksa rezulton se 43-vjeçari ka qenë i dënuar më parë për vjedhje me armë.

Armët dhe lënda narkotike e sekuestruar 43-vjeçarit

Redaksia
10 Dhjetor, 13:01 | **Përditesimi: 10 Dhjetor, 13:05**

Share

A A

KURBIN - Policia e Kurbinit ka parandaluar një ngjarje të mundshme kriminale falë ndërhyrjes së shpejtë, pas raportimeve të qytetarëve për një individ të armatosur me një mjet prerës që krijonte panik dhe kërcënonte në qytet.

Operacioni policor i koduar "Rekordet" përfundoi me arrestimin e shtetasit Gentian Diva, 43 vjeç, banues në Fushë Mamurras, i njohur për precedentë penalë të mëparshëm për vjedhje me armë dhe tentativë grabitjeje banke.

Gentian Diva kishte kërcënuar disa qytetarë, dëmtuar një automjet dhe terrorizuar klientët e një lokali. Gjatë arrestimit, Policia gjeti dhe sekuestroi një thikë, municion luftarak dhe një sasi lëndë narkotike të dyshuar Cannabis.

LEXO EDHE:
Lezhë, dalin nga ngujimi fëmijët e familjeve që vuajnë plagën e gjakmarrjes

'Shërbimet e Policisë në kuadër të operacionit policor të koduar "Rekordet", kanë kapur dhe vënë në pranga personin e denoncuar nga qytetarët, shtetasin G. D., 43 vjeç, banues në Fushë Mamurras. 43-vjeçari i kapur, i dënuar më parë për vjedhje me armë dhe për tentativë për grabitje në bankë. Ky shtetas ka kërcënuar disa qytetarë, pa asnjë shkak, ka thyer xhamin e një automjeti dhe ka terrorizuar klientët në një lokal. Në momentin e arrestimit, atij iu gjetën dhe iu sekuestruan një mjet prerës(thikë), municion luftarak dhe një sasi Cannabisi.', njofton policia.

Materialet procedurale janë referuar në Prokurori për veprime të mëtejshme ligjore.

G.K/Shqiptarja.com

TAG: Lezhe | Kurbin | arme zjarri | kanabis

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

10 Dhjetor, 10:15

Në përplasjen Veliaj-Berisha kujt i jepni të drejtë?

Veliaj | Berishës | Nuk e di

Lajme të tjera

Denoncimi i Partisë së Lirisë në Lezhë: PS shantazh administratës për vota
Elvis Hila
9 Dhjetor, 14:49

Lezhë/ Polici i hoqi veshjen e zezë të xhamave të makinës, i riu e kërcënon me mesazh! Vihet në pranga
9 Dhjetor, 13:35

Lezhë/ Filma për fëmijë te Qendra kulturore 'Gjergj Lacaj', dhjetori vjen me tematika festive
Elvis Hila
8 Dhjetor, 16:44

Shisnin kanabis në doza, arrestohen tre të rinj në Tiranë
8 Dhjetor, 15:21

Aksident në superstradën Lezhë-Shkodër, plagoset rëndë motoçiklisti 60-vjeçar! Dërgohet te Trauma, shoqërohet shoferi (EMRAT+VIDEO)
8 Dhjetor, 12:33

Botim i ri/ Dalin në dritë dokumentet e Arkivës së Shtetit, mbi veprimtarinë e politikanit dhe eruditit të shek.XX, At Ambroz Marlaskaj
Elvis Hila
7 Dhjetor, 16:27

Speciale/ Zef Zefaj, obstetër-gjinekologu i parë në Lezhë! Asistoi në lindjen e 43 mijë bebeve, operacioni i fundit pas 50 vitesh, poret lindjen e nipit
Elvis Hila
7 Dhjetor, 11:19

Ndizen dritat e festave edhe në Lezhë, qytetarë dhe fëmijë sfidojnë të ftohtin dhe shiun
6 Dhjetor, 19:15

Kufizimi i përdorimit të TikTok, kryeministri Rama: 394 takime, mbi 14 mijë prindër pjesëmarrës! Po kontribuojnë me ide dhe sugjerime (FOTO)
6 Dhjetor, 17:14

Eduard Zaloshnja: 48.1% e shtetasve shqiptarë nuk banojnë në Shqipëri
Eduard Zaloshnja
6 Dhjetor, 15:48

Italia nuk heq dorë nga kampet në Shqipëri, ministri i Brendshëm: Jemi në pritje të vendimit të Gjykatës së Kasacionit
6 Dhjetor, 15:36

Ekzekutimi i biznesmenit Ardian Nikulaj, Prokuroria e Lezhës çon në gjyq portugezin Ruben Saraiva! Vrasja për gjakmarrje! Veçohet dosja për 4 të tjerët (VIDEO)
Elvis Hila
6 Dhjetor, 13:33

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje